



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 37308/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sejdi Zahir Rexhepi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 17 par 1.5 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.12.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Sejdi Zahir Rexhepi, i lindur më 03.06.1962 në fsh. Tenezhdoll, tani jeton në lagjen Mati I Rr. Beqir Kastrati pn. ne Prishtine, i martuar baba i tre fëmijëve, Anëtar i Bordit ne Bankën Qendrore te Kosovës, i gjendjes mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si Anëtar i Bordit ne Bankën Qendrore te Kosovës, nuk e ka kryer obligimin ligjor për plotësuar formularin për deklarim te pasurisë sipas kërkesës të dt. 02.09.2011, në Agjencionin kundër korrupsionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtareve të Larte Publik.

Me kete mos veprim, ka kryer kundërvajtje nga neni 17 par 1.5 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, andaj

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merr formë të prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore KGJK-se nr. 100-4300-700-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Banke për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 33 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m .

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtror kërkesën nr. 01 4140/11 të dt. 25.10.2011, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Sejdi Rexhepi, për kundërvajtjen nga neni 17 par 1.5 të Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen ne pyetje te pandehurit i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se e është e vërtet se nuk e ka plotësuar formularin sipas kërkesës me numër te ref. AKK-DP te dt. 02.09.2011, duke

U deklaruar se as vet nuk e din shpërfaqjen tokësore pasi ajo është pasuri e përbashkët e prindërve dhe vëllezërve te tij, e gjithashtu ka pranuar se nuk ka dhënë informacione për shumën e pareve ne xhirollogarinë bankare atë te ProCredit Bank si dhe atë te Raiffeissen Bank. Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtarja mori ne pyetje dëshmitarin Agron Behramin, zyrtar ne Agjencionin kundër Korrupsionit, i cili deklaroi se pasi e kemi vërejtur se aplikacioni i Sejdi Rexhepit, Anëtar i Bordit ne Bankën Qendrore te Kosovës, ka shume zbrazesira menjëherë i kemi parashtruar kërkesë për plotësim te formularin sipas kërkesës me numër te ref.

Në bazë të dhënave të parashtruara në kërkesë, dëgjimit të pandehurit, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të dënimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së. nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj dënimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrojnë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi. nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtari
Lindita Jakupi

